

Titulli i lëndës: Didaktikë e përkthimit

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë, Dega e Gjuhës shqipe
Titulli i lëndës:	Didaktikë e përkthimit
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	Me zgjedhje
Viti i studimeve:	viti IV, semestri VIII
Numri i orëve në javë:	2 + 0
Kreditë ECTS:	5
Koha / Vendi:	Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof. ass.dr. Kadire Binaj - Ejupi
Të dhënat kontaktuese:	kadire.binaj@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Lënda mësimore përqendrohet në studimin e anës didaktike të mëimit të përkthimit. Në këtë lëndë ofrohen informata themelore e konceptore lidhur me procesin e përkthimit si kalim i tekstit gjuhësor nga një gjuhë në tjetrën.
Qëllimet e lëndës:	Objektivi i kësaj lënde është që t'u ndihmojë studentëve të mësojnë anën teorike të përkthimit dhe t'i njohin metodat dhe teknikat e përkthimit, pa marrë parasysh se cilat gjuhë të huaja i flasin ata. Qëllimi i lëndës është që studentët të njihen me gjerësisht me natyrën e përkthimeve si forma të komunikimit gjuhësor, me funksionet e përkthimit në kuadër të komunikimit, si dhe të njihen me disiplinën që merret me studimin tyre. Në kuadër të kursit studentët do të marrin informacione të përgjithshme mbi historinë dhe zhvillimin e përkthimeve. Në mënyrë specifike, ata do të njihen me llojet e përkthimeve, me ndarjet dhe nëndarjet e tyre.

Rezultatet e pritshme të nxënies:

Pas përfundimit të këtij kursi studenti i vlerësuar pozitivisht do të jetë në gjendje:

- ta kuptojë rëndësinë e përkthimit dhe të teknikave didaktike për aftësim në fushën e përkthimit;
- të kuptojë së nxënia dhe mësimi i këtyre mjeteve didaktike është një proces kompleks pedagogjik e linguistik;
- t'i njohë mjetet didaktike që mund të përdoren për mësimin e procesit të përkthimit;
- t'i analizojë mjetet didaktike dhe funksionimin e tyre në procesin e përkthimit nga njëra gjuhë në tjetrën, si dhe ta vlerësojnë ndikimin e tyre në specifikat që ka përkthimi si veprimtari komunikuese e gjuhësore;
- të njohë zhvillimin historik të përkthimit dhe funksionet e tij, si dhe t'i analizojnë tekstet e përkthyer.

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtime			
Punë praktike	30min	15	7.5
Përgatitje për test intermediar			
Konsultime me mësimdhënësin	10 min	15	2.5
Puna në terren			
Testi, punimi i seminarit			
Detyrë shtëpie	1	15	15
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja për provimin final	2	15	30
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	1	1	1
Projektet, prezantimet, etj.			
Total			116: 25= 4.64

		5 ECTS
Metodat e mësimdhënies:	Mësimi realizohet nëpërmjet ligjëratave dhe përkthimeve të teksteve të ndryshme. Përmes ligjëratave do të sqarohen çështje të caktuara teorike, për të vazhduar më pas me pjesën interaktive të ushtrimeve. Gjatë kohës së ushtrimeve studentët do të bëjnë përkthime e do të bëjnë vlerësim kritik të përkthimeve të caktuara. Do të analizohen e vlerësohen gjithashtu edhe detyrat e shtëpisë.	
Metodat e vlerësimit:	<ul style="list-style-type: none"> - Angazhimi dhe pjesëmarrja aktive 10% - Testi teorik 50% - Detyra praktike 40% - Gjithsej 100% 	
Literatura primare:	<ul style="list-style-type: none"> - Shykrane Gërmizaj, Translation Theory in the Classroom, Prishtinë, 2005. - Mirela Kumbaro, Metodologji dhe didaktikë e përkthimit me gojë, SHBLU, Tiranë, 2010. - Bardhyl Musai, Metodologjia e mësimdhënies, Tiranë, 2003. 4. - Bardhyl Musai, Mësimdhënia dhe të nxënit ndërveprues, Tiranë, 2008. - L. Radovicka – Z. Karapici – A. Toma, Gjuha Shqipe 1, 2 dhe 3, Shtëpia Botues e Libir Shkollor, Tiranë, 1975. - Wolfgang Klein. Second Language Acquisition. Cambridge Textbooks in Linguistics, Cambridge University Press. 1986 - Chris Kyriacou, Essential Teaching Skills, Second Edition, 1998. - Riza Brada, Metodologjia e gjuhës shqipe, Prishtinë, 2006. 	
Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> - Andrew Chesterman & E. Wagner, 2002. Can theory help translators? St Jerome, 152 p. ; - Mona Baker & G. Saldanha (ed.), 2009 (2nd edition). Encyclopedia of Translation Studies. Routledge. 665 p.; - Lawrence Venuti, 1998. The Translation Studies Reader. Routledge; - Jeremy Munday, 2006 (2nd edition). Introducing Translation Studies. Routledge. - Edith Grossman, Why Translation Matters?, Yale University Press, 2010 - Sofokli Garo, Sfidat e mësimdhënies (Metoda, strategji, teknika dhe këshilla praktike për mësues fillestarë), Tiranë, 2002. - Sofokli Garo, Mësimdhënia bashkëkohore, Tiranë, 2008. 	

Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Prezantimi i sillabusit
Java 2:	ÇKA ËSHTË PËRKTHIMI? NJOHURI TË PËRGJITHSHME PËR PROCESIN E PËRKTHIMIT
Java 3:	FORMAT DHE TIPAT E PËRKTHIMIT
Java 4:	PËRKTHIMI I TIPAVE DHE LLOJEVE TË NDRYSHME TË TEKSTEVE (PUNË PRAKTIKE)
Java 5:	Funksionet shoqërore të përkthimit
Java 6:	PËRKTHIMI ME GOJË DHE PËRKTHIMI ME SHKRIM (PUNË PRAKTIKE)
Java 7:	Procesi i përkthimit dhe prodhimi
Java 8:	TEKNIKAT E PËRKTHIMIT
Java 9:	Përkthimi i teksteve duke përdorur teknika të ndryshme (punë praktike)
Java 10:	TESTI TEORIK
Java 11:	ANALIZË KONTRASTIVE E TEKSTEVE TË PËRKTHYERA
Java 12:	PREZANTIMET E ANALIZËS KONTRASTIVE
Java 13:	PREZANTIMET E ANALIZËS KONTRASTIVE
Java 14:	PREZANTIMET E ANALIZËS KONTRASTIVE
Java 15:	PREZANTIMET E ANALIZËS KONTRASTIVE

Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Studentët janë të obliguar t'i vijojnë me rregull ligjëratat dhe ushtrimet. Nuk lejohen më shumë se tri mungesa gjatë semestrit. Detyrat që dalin nga këto orë mësimi janë të obligueshme dhe pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të studentit. Plagjiatura dhe kopjimi në provime dhe punimet e tjera me shkrim janë të dënueshme. Në rastet e tilla studentit u nënshtrohet masave disiplinore, siç parashihet me rregulloret e UP-së. Sjellja e mësimdhënësit dhe e studentëve bazohet në kodin e mirësjelljes dhe të etikës në kuadër të UP-së.